QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 20602 Prot.
Date 08.08.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.

DHKPGJP
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

SHOQËRIA PËRMBARIMORE SPAHIU

Nr. 446, Regj., Nr. 2286/1 Prot.

Tiranë, më 04/08/2022

# URDHËR

## PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

**Drejtuar :** Qendra Kombëtare e Biznesit, (QKB) Tiranë
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Tiranë

**Për dijeni:** Debitorit, Shoqëria "RHG" sh.p.k. me NIPT: L91520027A & Administrator z. Geri Kuka
Adresa: Rruga "Pjetër Bogdani", Godinë një katëshe, Pll.1/1, Tiranë.

Kreditorit, Subjekti Shoqëria "DHIMITRA" sh.p.k. me NIPT: J62903650R
Adresa: Dropull i Poshtëm, Derviçan, Gjirokastër.

**Objekti:** Pagesë Fature Tatimore

Unë, Eqerem Spahiu, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore "SPAHIU" sh.p.k, me numër NIPT:L62204027C, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr.15219, datë 04.07.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.446 kërkesën e kreditorit, Subjekti Shoqëria "DHIMITRA" sh.p.k. ndaj subjektit Shoqëria "RHG" sh.p.k., në lidhje me Titujt Ekzekutiv 133 Fatura Tatimore Shitje.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.2279/3 Prot, datë 18.07.2022, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit,

**KONSTATOVA se :**

Debitori, Shoqëria "RHG" sh.p.k., është vënë më dijeni për njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi. Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit, Subjektit Shoqëria "RHG" sh.p.k. në masën, që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b;c) dhe 53 të Ligjit Nr.26/2019, "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat".

**URDHËROJ**

**Vendosjen e masës së sekuestros konservative, mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga:**

**Debitori, Shoqëria "RHG" sh.p.k. me NIPT: L91520027A**
**Adresa: Rruga "Pjetër Bogdani", Godinë një katëshe, Pll.1/1, Tiranë.**

1. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në lidhje me proceduren e vënies së sekuestros nga ana juaj, në lidhje me:

   a. Adresen e ushtrimit të aktivitetit.
   b. Llojin e aktivitetit për të cilën është paisur me licence.
   c. Bllokimi e shitjes së aksioneve dhe tjetërsimi të aktivitetit.

2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3. Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

**ZYRA PËRMBARIMORE "SPAHIU" SH.P.K.**

Përmbarues GJYQËSOR

**Eqerem SPAHIU**

REPUBLIKA E SHQIPERISE EQEREM G.SPAHIU PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT

*Adresa: Rruga "Ded Gjo Luli", Pall.1, Shk.2., Kt.2., Ap.21., Tiranë, e-mail: info@spahiu.al, mob.+355682039585*